

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË  
KOSOVË

**P4**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 18.10.2025

**Pjesa A: Detyra me zgjidhje të shumëfishtë (vetëm një opsion i saktë)**

**Nga 2 pikë secila**

1. Në muajin Qershor 2025, Kompania INFOTECH SH.P.K me seli në Kosovë lëshoi një fature në vlerë 236,000.00 për shërbime të IT për një pranues të shërbimit i cili është i vendosur jashtë vendit. Sa do të jete vlera e TVSH-se ne këtë fature?

- a) 36,000.00 EUR
- b) 42,480.00 EUR
- c) 0.00 EUR

2. Kompania „X” SH.P.K në muajin Tetor 2025, ka pas një import të pajisjeve/aseteve nga Kina. Kosto totale e produkteve është 10,000.00 EUR, kosto e transportit 2,500.00 EUR, kosto e doganës 1,250.00 EUR, kosto e instalimit të pajisjes 500.00 EUR. Sa do të jete vlera e TVSH-se në këtë import?

- a) 2,475.00 EUR
- b) 2,565.00 EUR
- c) 2,250.00 EUR

3. Kompania “BluePeak” L.L.C ka blere një automjet të kompanisë në vlerë 41,300 EUR me (vlera përfshinë TVSH-në). Automjeti përdoret nga Drejtori I kompanisë për nevoja të biznesit dhe nevoja personale. Ne baze të matjeve dhe parashikimeve është vlerësuar se vetura do të përdoret 40 % për nevoja biznesore dhe 60% për nevoja personale. Sa do të jete vlera e TVSH-se së zbritshme në këtë fature?

- a) 6300.00 EUR
- b) 3150.00 EUR
- c) 2520.00 EUR

4. Kompania e Sigurimeve “TrustLine Insurance” ka lëshuar një fature për kompaninë „Prime” SH.P.K në muajin Shtator 2025, fatura përfshinë shërbime të ndryshime të ofruara; Sigurim shëndetësor për punëtorët e kompanisë 2,000.00 EUR- PA TVSH , Sigurim Kasko për veturat e kompanisë 8,000.00 EUR- PA TVSH , Sigurim për pronën e kompanisë në vlerë 10,000.00 EUR- PA TVSH. Sa do të jete vlera e TVSH-se në këtë fature?

- a) 3,600.00 EUR
- b) 3,240.00 EUR
- c) 0.00 EUR

5. Kompania "Nova" L.L.C, është kompani e cila mirëet me furnizimi të energji elektrike. Kompania është hapur ne ARBK me date 15 Janar 2025 dhe ka marr certifikatën e TVSH-së me 30 Qershor 2025. Gjate muajit Maj 2025 kompania ka pas total të hyra në vlerë 5,400.00 EUR. Sa është vlera e TVSH-së se paguar nga kompania në muajin Maj 2025?
- a) 400.00 EUR
  - b) 823.73 EUR
  - c) 0.00 EUR
6. Kompania "BrightPath" SH.P.K jep shërbime IT brenda dhe jashtë Kosovës. Ajo është në pronësi 100% të kompanisë "SmartWay Group" me seli në Holandë. Gjatë vitit 2025, "BrightPath" ka kryer shërbime IT për kompani të palidhura dhe gjithashtu për kompaninë mëmë në Holandë. Gjatë kontrollit që ATK ka kryer në biznesin "BrightPath" SH.P.K, është vërejtur se çmimi i shërbimeve të ofruara për kompaninë mëmë është 30% më i ulët se çmimi i shërbimeve të ofruara për kompanitë vendore në Kosovë. Cilat janë hapat që duhet të ndërmarrë ATK në këtë rast?
- a) ATK nuk ndërmerr asnjë veprim, pasi kompania ka të drejtë të caktojë çmimet sipas marrëveshjeve të saj tregtare.
  - b) ATK duhet të kërkojë dokumentacionin e çmimeve të transferimit (transfer pricing documentation) dhe të vlerësojë nëse çmimet janë në përputhje me parimin e "çmimit të tregut të lirë"
  - c) ATK duhet të kërkojë nga kompania që të zvogëloi çmimet për të gjitha shërbimet që ofron për kompanitë vendore.
7. Kompania "Y" L.L.C, e cila merret me tregti dhe nuk tatohet sipas skemës së tatimit mbi të ardhurat reale, është regjistruar si biznes ne ARBK më 5 Tetor 2024, gjatë TM4 të vitit 2024 ka pasur: Të ardhura bruto 15,000.00 EUR, shpenzimet e pagave 2,000.00 EUR, shpenzime te tjera administrative 3,000.00 EUR. Tatimi ne te ardhurat e korporatave është 10%. Sa ka paguar tatim ne fitim gjate vitit 2024 kompania „Y” L.L.C?
- a) 1,000.00 EUR
  - b) 450.00 EUR
  - c) 1,350.00 EUR

8. Kompania "BluePeak" L.L.C gjate vitit 2024 ka pasur te ardhura bruto 1,200,000.00 EUR. Shpenzimet e kompanisë kane qene: Shpenzimet e pagave 200,000.00 EUR, shpenzimet e shtijës 150,000.00 EUR, shpenzimet operative 100,000.00 EUR, shpenzimet e gjobave 10,000.00 EUR, shpenzimet e dhuratave për punëtor 2,000.00 dhe ka sponsorizuar 1,000 € për kulturë. Sa është tatimi në fitim nëse norma e tatimit është 10%?
- a) 73,700.00 EUR
  - b) 72,800.00 EUR
  - c) 74,000.00 EUR
9. Nara, punon në një kompani marketingu, me një page mujore bruto prej 1200.00 EUR. Ne fillim te vitit për shkak te performances se jashtëzakonshme, Nares ju rrit paga për 300.00 EUR bruto. Duke marre këtë parasysh sa do te jete paga neto e Nares pas rritjes?
- a) 1,311.50 EUR
  - b) 1,304.70 EUR
  - c) 1,720.47 EUR
10. Kompania "GreenTech" shiti gjeneratorë elektrikë për 60,000 € (pa TVSH) dhe aplikoi një zbritje për klientë të rregullt prej 5%. Sa ishte shuma përfundimtare e shitjes me TVSH përfshirë zbritjen?
- a) 67,260.00 EUR
  - b) 70,800.00 EUR
  - c) 57,456.00 EUR

**Pjesa B. Pyetjet përgjigje të shumëfishtë (vetëm një opsion i saktë) Nga 1 pikë secila**

**Ligji për TVSH**

1. Kur një person është i obliguar të regjistrohet në TVSh për shkak të kalimit të qarkullimit që referohet në ligj, ai duhet të njoftoj ATK brenda 15 dite kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim. Kur hyn në fuqi regjistrimi për TVSh:
  - a. 15 kalendarike pas momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim
  - b. 30 dite kalendarike pas momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim
  - c. Ne datën kur tejkalohet qarkullimi
2. Nëse kemi të bëjmë me një shërbim si një ngjarje kulturore, artistike, sportive apo shkencore, cili është vendi i furnizimit të shërbimeve për personat e tatueshëm:
  - a. Vendi ku ofruesi i shërbimit e ka themeluar biznesin e tij
  - b. Vendi ku pranuesi i shërbimit e ka themeluar biznesin e tij
  - c. Vendi ku në të vërtetë ndodh shërbimi
3. Shuma e tatueshme për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve përfshin:
  - a. Tatimet, detyrimet, taksat dhe komisionet duke përjashtuar TVSh-ne
  - b. Tatimet, detyrimet, taksat dhe komisionet duke përfshirë TVSh ne
  - c. Asnjëra prej me larte
4. Norma e TVSh-se për furnizimi i barnave, produkteve farmaceutike, instrumenteve dhe aparateve mjekësore dhe kirurgjike është:
  - a. 18%
  - b. 8%
  - c. 0%
5. Cili prej transaksioneve të mëposhtme është aktivitet i caktuar me interes publik, pa të drejtën e zbritjes së TVSh-se së zbritshme:
  - a. furnizimi i barnave, produkteve farmaceutike, instrumenteve dhe aparateve mjekësore dhe kirurgjike
  - b. ofrimi i kujdesit mjekësor në ushtrimin e profesioneve mjekësore dhe para mjekësore siç janë përkufizuar me ligjet në fuqi të Kosovës
  - c. furnizimi me energji elektrike, përfshirë shërbimet e transmissioinit dhe distribuimit, me ngrohje qendrore, mbledhjen e hedhurinave dhe trajtimin e mbeturinave tjera

6. Ne rast pasuria e paluajtshme që është pjesë e aseteve të biznesit të një personi të tatueshëm dhe shfrytëzohet për qëllime të biznesit të personit të tatueshëm dhe për shfrytëzim privat ose për stafin e tij, ose në përgjithësi, për qëllime tjera nga ato të biznesit të tij, TVSH-ja mbi shpenzimet që lidhen me këtë pasuri do të jetë e zbritshme:
  - a. 100% e vlerës së TVSh-se të pasurisë
  - b. deri në pesëdhjetë përqind (50%) të vlerës së TVSH se pasurisë
  - c. vetëm deri në proporcionin e shfrytëzimit të pasurisë për qëllime të biznesit të personit të tatueshëm.
  
7. Deri kur mund ta zbrisë personi i tatueshëm TVSH-në e tij të zbritshme, nëse nuk e ka zbatuar në periudhën tatimore përkatëse :
  - a. Në çdo kohë pa kufizim kohor.
  - b. Vetëm brenda vitit në të cilin ka lindur e drejta për zbritje.
  - c. Jo më vonë se në periudhën e fundit tatimore të vitit kalendarik që vijon pas vitit në të cilin ka pasur të drejtën për zbritje
  
8. Pas sa muajsh bartjeje radhazi të tepricës së TVSH-së së zbritshme, personi i tatueshëm mund të dorëzojë kërkesë për rimbursim të TVSH-së?
  - a. Pas një (1) muaji bartjeje radhazi.
  - b. Pas tre (3) muajve bartjeje radhazi.
  - c. Pas gjashtë (6) muajve bartjeje radhazi.
  
9. Në rastet kur mallrat dhe shërbimet përdoren si për transaksione me TVSH të zbritshme ashtu edhe për ato pa të drejtë zbritjeje, cila pjesë e TVSH-së është e zbritshme?
  - a. E gjithë shuma e TVSH-së për mallrat dhe shërbimet e shfrytëzuara.
  - b. Asnjë pjesë e TVSH-së nuk është e zbritshme.
  - c. Vetëm pjesa e TVSH-së që i atribuohet transaksioneve për të cilat TVSH-ja është e zbritshme
  
10. Kur bëhet TVSH-ja e ngarkueshme në rastet kur pagesa kryhet para furnizimit të mallrave dhe shërbimeve dhe para lëshimit të faturës?
  - a. Në momentin kur mallrat dhe shërbimet furnizohen
  - b. Në pranimin e pagesës dhe vetëm për shumën e pranuar.
  - c. Në momentin kur është lëshuar fatura

## LIGJI PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE

11. Objekti i tatimit për tatimpaguesin rezident janë:
- Vetëm të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë,
  - Vetëm të ardhurat e tatueshme me burim jashtë Kosovës,
  - Të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë dhe jashtë Kosovës
12. Cilat nga me poshtë janë shpenzime për te cilat nuk lejohet zbritje gjate përcaktimit të te ardhurave të tatueshme:
- shpenzimet për dhurata, te cilat janë me emër dhe logo të biznesit,
  - shpenzimet për qiratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve rezident dhe jorezident
  - Shpenzimet e interesit te kredisë
13. Në çfarë përqindje të të ardhurave vjetore janë të kufizuara shpenzimet e përfaqësimit?
- Në tre përqind (3%) të të ardhurave bruto vjetore.
  - Në një përqind (1%) të të ardhurave neto vjetore.
  - Në një përqind (1%) të të ardhurave bruto vjetore.
14. Për sa periudha tatimore mund të bartet humbja tatimore për t'u zbritur nga të ardhurat e viteve pasuese?
- Deri në dy (2) periudha tatimore të njëpasnjëshme.
  - Deri në katër (4) periudha tatimore të njëpasnjëshme.
  - Deri në pesë (6) periudha tatimore të njëpasnjëshme.
15. Në cilin rast bartja e humbjes tatimore nuk është më e zbatueshme?
- Kur biznesi ka krijuar fitim në vitin vijues.
  - Kur biznesi ndryshon llojin e organizatës ose pronësinë për më shumë se pesëdhjetë përqind (50%)
  - Kur biznesi zgjeron aktivitetin e tij me një degë të re

16. Sa është % e mbajtës se tatimit ne burim nga interesi në kreditë e marra nga institucionet financiare të licencuara nga BQK?

- a. 10%
- b. 9%
- c. 0%

17. Sa është përqindja e tatimit në burim që zbatohet për të ardhurat e një personi apo entiteti jo-rezident nga aktivitetet ose shërbimet e kryera fizikisht në Kosovë?

- a. Pesë përqind (5%) e kompensimit bruto.
- b. Dhjetë përqind (10%) e kompensimit bruto
- c. Nëntë përqind (9%) e kompensimit bruto

#### LIGJI PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT PERSONALE

18. Cilat nga të ardhurat e mëposhtme përfshihen në të ardhurat bruto nga pagat?

- a. Pagesa e shpenzimeve personale të punonjësit nga punëdhënës
- b. Dëmshpërblimi për aksidentet në punë
- c. Përfitimet në natyrë në formë të shujtave dhe transportit të ofruara nga punëdhënësi për punëtorin duke përjashtuar kompensimin në para

19. Kur dhuratat në para ose gjësende të pranuar nga rezidentët përfshihen në të ardhurat tjera tatimore?

- a. Për çdo dhuratë, pa marrë parasysh shumën.
- b. Vetëm kur dhuratat tejkalojnë shumën pesëmijë euro (5.000 €) në një periudhë tatimore.
- c. Vetëm kur dhuratat janë më pak se pesëmijë euro (5.000 €) në një periudhë tatimore

## LIGJI PËR ADMINISTRIMIN E PROCEDURAVE TATIMORE

20. Sa vite duhet të mbahen regjistrat që lidhen me shërbimet elektronike pas përfundimit të periudhës tatimore kur janë ofruar?

- a. 4 vite.
- b. 10 vite.
- c. 6 vite.

21. Cila është vlera minimale e një transaksioni që kërkohet të bëhet përmes llogarisë bankare ose formave tjera të pagesës elektronike ndërmjet personave të përfshirë në aktivitet ekonomik?

- a. 200 euro
- b. 300 euro
- c. 500 euro

22. Brenda sa kohe mund të dorëzohet kërkesa për kreditim ose rimbursim për një pagesë të tepërt të tatimit?

- a. 3 vite nga data kur është paguar tatimi apo kur ka lindur e drejta e zbritjes
- b. 6 vite nga data kur është paguar tatimi apo kur ka lindur e drejta e zbritjes
- c. 4 vite nga data kur është paguar tatimi apo kur ka lindur e drejta e zbritjes

23. Në cilat raste Administrata Tatimore e Kosovës nuk mund të bëjë vizita pa njoftim paraprak?

- a. Kur tatimpaguesi ka borxhe tatimore të papaguara.
- b. Kur tatimpaguesi është përzgjedhur për kontrollë
- c. Kur tatimpaguesi ndryshon adresën e biznesit

24. Sa është gjoba për një person që kryen veprimtari pa marrë certifikatën e kërkuar sipas ligjeve tatimore të Republikës së Kosovës?

- a. 300 euro
- b. 500 euro
- c. 1000 euro

25. Sa është gjoba për një person juridik që nuk e dorëzon një deklaratë tatimore të obligueshme në afatin e përcaktuar, e cila rezulton me detyrim tatimor?

- a. 150 euro
- b. 300 euro
- c. 500 euro

26. Brenda sa ditësh tatimpaguesi mund të paraqesë kërkesë për rishqyrtim në Njësinë e Ankesave pas pranimit të njoftimit të vlerësimit ose përcaktimit zyrtar nga ATK?

- a. 45 dite
- b. 15 dite
- c. 30 dite

## LIGJI PËR SHOQËRITË TREGTARE

27. Cilat nga subjektet e mëposhtme janë të detyruara të regjistrohen në Regjistrin e Bizneseve (ARBK)?

- a. Vetëm Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe Shoqëritë Aksionare
- b. Vetëm Bizneset Individuale
- c. Të gjitha Shoqëritë Tregtare si: Bizneset Individuale, Ortakëritë e Përgjithshme e të Kufizuara, Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar dhe Shoqëritë Aksionare
- d. Vetëm Degët e Shoqërive të Huaja Tregtare

28. Kush janë përfaqësuesit e autorizuar të shoqërive tregtare për korporata?

- a. Asambleja e aksionarëve
- b. Themeluesit e korporatës
- c. Drejtorët menaxhues

29. Çfarë dokumenti e zëvendëson Marrëveshjen e Inkorporimit kur Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar ka vetëm një themelues?
- a. Statuti i Shoqërisë
  - b. Akti i Themelimit
  - c. Certifikata e Regjistrimit
30. Sa duhet të jetë përqindja minimale e pjesëmarrjes së grave në Bordin e Drejtorëve të Shoqërisë Aksionare?
- a. 30 %
  - b. 40%
  - c. 50%
31. A është Dega e Shoqërisë së Huaj Tregtare person juridik i veçantë nga Shoqëria e Huaj që e ka themeluar atë?
- a. Po, është person juridik i veçantë
  - b. Jo, nuk është person juridik i veçantë
  - c. Vetëm nëse ka kapital të ndarë
32. Si mund të angazhohet një Shoqëri e Huaj Tregtare në veprimtari ekonomike në Kosovë?
- a. Përmes regjistrimit të një Dege të Shoqërisë së Huaj Tregtare
  - b. Përmes regjistrimit të një Zyrë të Përfaqësisë në Kosovë
  - c. Të dyja më lartë

## LIGJI PER KONTABILITET, RAPORTIM FINACIAR DHE AUDITIM

33. Përgatitja e pasqyrave financiare për ndërmarrjet e mesme behet sipas:

- a. Sipas SNRF për NVM
- b. Sipas SNRF të plota
- c. Sipas politikave kontabël

34. Njëri nga tri kushtet për klasifikim si ndërmarrjet e vogla është numëri i të punësuarve mbi 10 deri ne 50.

- a. Nga 0-10
- b. Nga 10-50
- c. Mbi 10

35. Pasqyrat financiare të konsoliduar që auditohen në pajtim me SNA-të dhe në pajtim me Ligjin Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim dorëzohen në KKRF jo më vonë se:

- a. 31 Mars
- b. 30 Prill
- c. 30 Qershor

## LIGJ TË PUNËS

36. Nga cila moshë një person mund të themelojë marrëdhënie pune?

- b. Nga mosha pesëmbëdhjetë (15) vjeç.
- c. Nga mosha tetëmbëdhjetë (18) vjeç.
- d. Nga mosha njëzet (20) vjeç.

37. Cila është periudha maksimale për të cilën mund të lidhet një kontratë për periudhë të caktuar?

- a. 5 vite
- b. 10 vite
- c. 15 vite

38. Sa ditë njoftim paraprak duhet të japin punëdhënësi ose i punësuar për të ndërprerë marrëdhënien e punës gjatë periudhës provuese?

- a. 30 dite
- b. 15 dite
- c. 7 dite

39. Cili është orari maksimal i punës në javë për një të punësuar që është më i ri se tetëmbëdhjetë (18) vjeç?

- a. 20 ore ne jave
- b. 30 ore ne jave
- c. 40 ore ne jave

40. Sa ditë pune shtesë pushim vjetor kanë të drejtë nënat me fëmijë deri në tre (3) vjeç, prindi vetushqyes dhe personat me aftësi të kufizuara?

- a. 2 dite pune shtese
- b. 3 dite pune shtese
- c. Asnjë dite pune shtese

## Pjesa C. Pyetjet problemore

### Problemi 1

(15 pikë)

Kompania "TradeLink Global" L.L.C., me seli në Prishtinë, ka paraqitur të dhënat financiare që pasqyrojnë aktivitetin e saj afarist gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2024. Kompania vepron në fushën e importit dhe eksportit të pajisjeve industriale, duke realizuar shitje me para në dorë, shitje me afat pagese, eksportime, si dhe duke pasur shpenzime operative dhe investuese. (Shumat nuk përfshijnë TVSH-në, përveç rasteve kur është specifikuar ndryshe)

- Shitje me afat pagese për biznese: **250,000.00 EUR**
- Shitje me para në dorë për klientë: **354,000.00 EUR** (përfshirë TVSH 18%)
- Parapagime të pranuar nga klientët për porosi që do të realizohen në vitin 2025: **150,000.00 EUR** (nuk përfshihen në shitjet e mësipërme)
- Parapagime të pranuar në gusht 2024, të realizuara në shitje gjatë tetorit 2024: **50,000.00 EUR** (nuk përfshihen në shitjet e mësipërme)
- Eksporte: **200,000.00 EUR**
- Importe të rregullta të mallrave tregtare: **153,400.00 EUR** (përfshirë TVSH 18%)
- Shpenzime administrative: **15,000.00 EUR**
- Blerje e aseteve afatgjata: **50,000.00 EUR** (normë lineare e zhvlerësimit 20%)
- Parapagime të dhëna për furnitorë për importe të rregullta të mallrave: **32,000.00 EUR**
- Paga neto: **40,000.00 EUR**
- Kontribute pensionale të punëdhënësit: **7,000.00 EUR**
- Kontribute pensionale të punëmarrësve: **7,000.00 EUR**
- Tatimi në paga: **11,000.00 EUR**
- Stoqe në fillim të vitit: **220,000.00 EUR**
- Stoqe në fund të vitit: **120,000.00 EUR**
- Shpenzime të interesit të kredisë: **2,570.00 EUR**
- Shpenzime për gjoba dhe ndëshkime nga Administrata Tatimore e Kosovës: **1,500.00 EUR**
- Sponsorizim gjatë vitit 2024 për Klub Futbollistik "Prishtina": **20,000.00 EUR**

### Kërkesat

- a) Llogaritni të ardhurat e tatueshme për vitin 2024
- b) Llogaritni KMSH për vitin 2024.
- c) Llogaritni tatimin në fitim për vitin 2024 duke aplikuar normën tatimore 10%.

**ZGJIDHJE**

**a) Llogaritja e të ardhurat e tatueshme për vitin 2024:**

Shitje me afat pagese per biznese	250,000.00
Shitje kesh per kliente ( 354,000/1.18)	300,000.00
Parapagime te realizuara ne shitje	50,000.00
Eksporte	200,000.00
<b>Te ardhurat e tatueshme</b>	<b>800,000.00</b>

**b) Llogaritja e KMSH-se**

Stoqet ne fillim te vitit	220,000.00
Blerjet	153,400.00
Stoqet ne fund te vitit	120,000.00
<b>KMSH</b>	<b>253,400.00</b>

**c) Llogaritja e tatimin në fitim për vitin 2024 duke aplikuar normën tatimore 10%**

Shitje me afat pagese per biznese	250,000.00
Shitje kesh per kliente ( 354,000/1.18)	300,000.00
Parapagime te realizuara ne shitje	50,000.00
Eksporte	200,000.00
<b>Te ardhurat e tatueshme</b>	<b>800,000.00</b>

Stoqet ne fillim te vitit	(220,000.00)
Blerjet	(153,400.00)
Stoqet ne fund te vitit	(120,000.00)
<b>KMSH</b>	<b>(253,400.00)</b>

Shpenzime administrative	(15,000.00)
Pagat Bruto ( 40,000 +7,000+7,000+11,000)	(65,000.00)
Shpenzimet e interesit te kredise	(2,570.00)
Shpenzimet e zhvleresimit (32,000*20%)	(6,400.00)
<b>Shpenzimet e zbritshme</b>	<b>(88,970.00)</b>

<b>Te ardhurat e tatueshme</b>	<b>457,630.00</b>
--------------------------------	-------------------

<b>Tatimi ne Fitim (457,630.00 *10%)</b>	<b>45,763.00</b>
--	------------------

Sponsorizimi ( 45,763.00*30%)	(13,728.90)
-------------------------------	-------------

<b>Tatimi ne Fitim i pagueshem</b>	<b>32,034.10</b>
------------------------------------	------------------

## Problemi 2

(15 pikë)

Kompania ndërtuese Invest Group sh.p.k është investitor në ndërtimin e një objekti për banim dhe afarist ne Prishtine. Objekti te cilin kompania po e ndërton ka një sipërfaqe totale prej 2500 m2 te ndara si me poshtë:

- 85% për banim
- 15% për afarizëm.

Gjate muajit Qershor 2025, kompania ka pas transaksionet si me poshtë:

- Shitje te banesave te banim: 250,000.00 EUR
- Shitje te garazhave: 78,000.00 EUR
- Shitje te lokaleve për afarizëm: 300,000.00 EUR.
- Paga Bruto: 12,000.00 EUR
- Shpenzime te marketingut: 9,000.00 EUR (pa TVSH, TVSH 18%)
- Shpenzime noteriale: 4,500.00 EUR (pa TVSH, TVSH 18%)
- Shpenzime te rrymës : 350.00 EUR (pa TVSH, TVSH 8%)
- Blerje te mallit për ndërtim: 177.000.00 ( me TVSH, TVSH 18%)
- Kreditimi I bartur nga muaji Korrik 2025 është: 23,850.00 EUR

### *Kërkesat*

- a) Llogaritni Koeficientin e zbritshem te TVSH-se
- b) Hartoni deklaratën mujore të TVSH-së për Gusht 2025
- c) Përcaktoni sa është pagesa/kreditimi e TVSH-se për muajin Gusht

## ZGJIDHJE

a) Koeficienti i zbritshëm ne ndërtimtari bazohet ne pjesëmarrjen e afrizimit te tatushem.  
Ne rastin tone 15%

b)

<b>Deklarata mujore e TVSH-së për Gusht 2025</b>		
<b>Rubrika</b>	<b>Vlera</b>	<b>TVSH</b>
<b>B. Shitjet e përjashtuara (banesa + garazhe)</b>	328,000	
<b>A. Shitjet e tatueshme me 18 %</b>	300,000	54,000.00
<b>C. TVSH e llogaritur</b>		54,000.00
<b>D. Blerjet me TVSH pa te drejt kreditimi (85%)</b>	164,341.55	
<b>F. Blerjet vendore -mall + shpenzime (15 % e vleres)</b>	24,578	4,423.95
<b>E. Totali i zbritshëm</b>		4,423.95
<b>G. Kreditim i bartur nga muaji paraprak</b>		23,850
<b>H. TOTAL (F+E)</b>		28,273.95
<b>I. TVSH për pagesë (C - H)</b>		25,726.05

Sqarim:

F.Blerjet	Vlera	TVSH	kof	Verla me kof 15%	TVSH e zbritsh
Marketing	9,000.00	1,620.00	15%	1,350.00	243.00
Shp.Noteriale	4,500.00	810.00	15%	675.00	121.50
Shpnz, e rrynes	350.00	63.00	15%	52.50	9.45

Malli per ndertim	150,000.00	27,000.00	15%	22,500.00	4,050.00
Total	163,850.00	29,493.00		24,577.50	4,423.95
Blerja pa TVSH	164,341.55				

C) Pagesa per muajin Gusht 2025 eshte 25,726

### Problemi 3

(5 pikë)

Kompania "GreenBuild Energy" Sh.p.k, e themeluar në vitin 2015, operon në sektorin e prodhimit të pajisjeve laboratorike në Kosovë. Në fund të vitit 2024, kompania raportoi shpenzime për zhvlerësimin e aseteve të saj kryesore, duke përdorur politika kontabël në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS).

Megjithatë, gjatë përgatitjes së deklaratës tatimore, u vërejtën mospërputhje mes zhvlerësimit kontabël dhe atij tatimor sipas Ligjit Tatimor të Kosovës, veçanërisht për disa mjete transporti dhe pajisje prodhimi.

#### Grupi I:

- Ndërtesa e Administratës Qendrore: 60,000 €
- Depoja e Materialeve: 40,000 €

#### Grupi II:

- Kamioni për Transport të Pajisjeve laboratorike: 20,000 €
- Pajisje Elektronike për Montim: 15,000 €

#### Grupi III:

- Linja Automatike e Montimit: 25,000 €
- Pajisje për Testimin e Cilësisë: 10,000 €

Informacion shtesë:

Politikat kontabël për zhvlerësimin e këtyre aseteve përdorin këto norma:

- Grupi I: 2%
- Grupi II: 15%
- Grupi III: 25%

Sipas Ligjit Tatimor të Kosovës:

- Grupi I: ?
- Grupi II: ?
- Grupi III: ?

Vlen të theksohet se vlera e Ndërtesës së Administratës Qendrore, e raportuar më sipër në shumën prej 60,000.00 EUR, është rezultat i rivlerësimit të kryer nga një rivlerësues i pavarur më datë 01.01.2024. Para kësaj date, vlera e mbetur në libra e pasurisë ka qenë 10,000.00 EUR

### *Kërkesat*

- a. Llogaritni zhvlerësimin kontabel 2024 për secilin aset sipas politikave kontabel .
- b. Llogaritni zhvlerësimin tatimor 2024 për secilin aset sipas normave ligjore të grupeve I-III.
- c. Krahasoni zhvlerësimin kontabël me zhvlerësimin tatimor dhe identifikoni diferencat kohore.
- d. Analizoni ndikimin e diferencave në fitimin tatueshëm dhe në TAK për vitin 2024.

### **ZGJIDHJE**

**a. Llogaritni zhvlerësimin kontabel 2024 për secilin aset sipas politikave kontabel .**

Grupi	Pershkrimi i asetit	Shuma	% e zhvleresimit	Shpenzimet e zhvleresimit 2024
Grupi I	Ndërtesa e Administratës Qendrore	60,000	2%	1,200.00
Grupi I	Depoja e Materialeve	40,000	2%	800.00
Grupi II	Kamioni për Transport të Paisjeve laboratorike	20,000	15%	3,000.00
Grupi II	Pajisje Elektronike për Montim	15,000	15%	2,250.00
Grupi III	Linja Automatike e Montimit	25,000	25%	6,250.00
Grupi III	Pajisje për Testimin e Cilësisë	10,000	25%	2,500.00
		<b>170,000</b>		<b>16,000.00</b>

**b. Llogaritni zhvlerësimin tatimor 2024 për secilin aset sipas normave ligjore të grupeve I-III.**

Grupi	Pershkrimi i asetit	Shuma	% e zhvleresimit	Shpenzimet e zhvleresimit 2024
Grupi I	Ndërtesa e Administratës Qendrore	10,000	5%	500.00
Grupi I	Depoja e Materialeve	40,000	5%	2,000.00
Grupi II	Kamioni për Transport të Paisjeve laboratorike	20,000	20%	4,000.00
Grupi II	Pajisje Elektronike për Montim	15,000	20%	3,000.00
Grupi III	Linja Automatike e Montimit	25,000	10%	2,500.00
Grupi III	Pajisje për Testimin e Cilësisë	10,000	10%	1,000.00
		<b>120,000</b>		<b>13,000.00</b>

**c. Krahasoni zhvlerësimin kontabël me zhvlerësimin tatimor dhe identifikoni diferencat kohore**

		Zhvlerësimi sipas politikave kontabel				Zhvlerësimi sipas normave ligjore				Diferencat
Grupi	Pershkrimi i asetit	Shuma	% e zhvlerësimit	Vitet per zhvlerësim	Shpenzimet e zhvlerësimit 2024	Shuma	% e zhvlerësimit	Vitet per zhvlerësim	Shpenzimet e zhvlerësimit 2024	
Grupi I	Ndërtesa e Administratës Qendrore	60,000	2%	50	1,200.00	10,000	5%	20	500	700.00
Grupi I	Depoja e Materialeve	40,000	2%	50	800	40,000	5%	20	2,000.00	-1,200.00
Grupi II	Kamioni për Transport të Paisjeve laboratorike	20,000	15%	6.67	3,000.00	20,000	20%	5	4,000.00	-1,000.00
Grupi II	Pajisje Elektronike për Montim	15,000	15%	6.67	2,250.00	15,000	20%	5	3,000.00	-750.00
Grupi III	Linja Automatike e Montimit	25,000	25%	4	6,250.00	25,000	10%	10	2,500.00	3,750.00
Grupi III	Pajisje për Testimin e Cilësisë	10,000	25%	4	2,500.00	10,000	10%	10	1,000.00	1,500.00
		<b>170,000</b>			<b>16,000.00</b>	<b>120,000</b>			<b>13,000.00</b>	<b>3,000.00</b>

**d. Analizoni ndikimin e diferencave në fitimin tatueshëm dhe në TAK për vitin 2024.**

Zhvlerësimi Kontabel	€ 16,000.00
Zhvlerësimi Tatimor	€ 13,000.00
Rritje shtesë e fitimit tatueshëm	€ 3,000.00
Norma tatimore	10%
<b>Rritje e TAK 2024</b>	<b>€ 300.00</b>

## Problemi 4

(5 pikë)

Kompania “Future Vision” Sh.p.k. ka në staf pesë të punësuar, për të cilët kërkohet të bëhet përlllogaritja e pagave për muajin **shtator 2025**. Pagat bruto dhe të dhënat për secilin punonjës janë si më poshtë:

- Drejtori – Paga Bruto: **3,500.00 EUR**
- Menaxheri i Shitjes – Paga Bruto: **2,000.00 EUR**
- Menaxheri i Marketingut – Paga Bruto: **1,850.00 EUR**
- Punëtori i Administratës – Paga Bruto: **800.00 EUR**
- Kontabilisti i Kompanisë – Paga Bruto: **700.00 EUR**

Gjatë muajit shtator ka pasur **22 ditë pune**. Për shkak të intensitetit të lartë të punës:

- Menaxheri i Shitjes ka punuar **2 të shtuna radhazi** (dita e shtunë nuk konsiderohet ditë pune);
- Menaxheri i Marketingut ka kryer **10 orë pune jashtë orarit**.

Gjithashtu, kontabilisti i kompanisë **nuk është punëtor primar** i “Future Vision” Sh.p.k.

Kompania paguan gjithashtu **sigurim shëndetësor** për secilin të punësuar (përveç kontabilistit), dhe vlera e këtij sigurimi **përfshihet në pagën bruto** të punonjësit. Shuma e sigurimit shëndetësor për secilin është **25.00 EUR në muaj**.

### *Kërkesat*

a) Të llogaritet për secilin punonjës:

- Kontributi pensional
- Detyrimi për tatimin në paga, sipas **normave të reja tatimore**
- Paga neto që duhet t’i paguhet secilit punonjës

b) Të llogariten **shpenzimet totale të pagave dhe kontributeve pensionale** për të gjithë punonjësit së bashku.

c) Të llogariten **detyrimet totale të kompanisë “Future Vision” Sh.p.k.** për paga dhe tatimet që lidhen me to për muajin **shtator 2025**.

## ZGJIDHJE

### a) Të llogaritet për secilin punonjës:

Punetoret	Punë Primare	Paga Bruto	Dite pune	Paga per dite	Paga per ore	Dite shtese	% shtese e pageses	Pagesa per pune shtese	Bruto paga për muaj	Kontributi pensional i të punësuarit	Kontributi pensional i punëdhënësit	Tatimi ne page	Paga neto	Sigurimi shendetsor	Paga per pagese
Drejtori	PO	3,500.00	22	159.09	19.89	0	0	-	3,500.00	175.00	175.00	303.50	3,021.50	25.00	2,996.50
Menaxheri i Shitjes	PO	2,000.00	22	90.91	11.36	2	50%	272.73	2,272.73	113.64	113.64	186.91	1,972.18	25.00	1,947.18
Menaxheri i Marketingut	PO	1,850.00	22	84.09	10.51	10	30%	136.65	1,986.65	99.33	99.33	159.73	1,727.59	25.00	1,702.59
Punëtori i Administratës	PO	800.00	22	36.36	4.55	0	0	-	800.00	40.00	40.00	47.00	713.00	25.00	688.00
Kontabilisti i Kompanisë	JO	700.00	22	31.82	3.98	0	0	-	700.00	35.00	35.00	66.50	598.50	-	598.50

b. Llogaritja e tatimit ne page:

	Drejtori	Menaxheri i Shitjes	Menaxheri i Marketingut	Punëtori i Administratës	Kontabilisti i Kompanisë
Paga Bruto	3,500.00	2,272.73	1,986.65	800.00	700.00
KP	175.00	113.64	99.33	40.00	35.00
KP	175.00	113.64	99.33	40.00	35.00
Paga para tatimit	3,325.00	2,159.09	1,887.32	760.00	665.00
<b>Tatimi</b>					
Paga prej 0-250 € - 0%	-	-	-	-	-
Paga prej 250-450 € -8 %	16.00	16.00	16.00	16.00	
Paga mbi 450 € -10%	287.50	170.91	143.73	31.00	
Tatimi per punetor sekondar - 10%	-	-	-	-	66.50
<b>Gjithsej tatimi</b>	<b>303.50</b>	<b>186.91</b>	<b>159.73</b>	<b>47.00</b>	<b>66.50</b>
Paga NETO	3,021.50	1,972.18	1,727.58	713.00	598.50

**a) Të llogariten shpenzimet totale të pagave dhe kontributeve pensionale për të gjithë**

Shpenzimet totale te pagave: 9,259.38 EUR

Shpenzimet totale te kontributeve pensionale: 462.97 EUR

**b) Të llogariten detyrimet totale të kompanisë "Future Vision" Sh.p.k. për paga dhe tatimet që lidhen me to për muajin shtator 2025.**

- Detyrimet per paga neto 7,932.77 EUR
- Detyrimet per kontribute pensionale: 925.94 EUR
- Detyrimet per tatimin ne page: 763.64